



I.L.D.K.P.

INSPEKTORATI I LARTE I DEKLARIMIT
DHE KONTROLLIT TE PASURIVE

KOMENTAR LIGJOR Nr. 1

I Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive

Nëntor 2005

Përbajtja

1.	Komentar	5-11
2.	Memorandum bashkëpunimi ndërmjet Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme	12-13
3.	PROJEKTRREGULLORE “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”	14-18
4.	DEKLARIM rast për rast i interesave private të zyrtarit në ushtrimin e funksioneve publike	19
5.	Regjistri i konfliktit të interesave	20
6.	Format autorizimi për deklarimin rast për rast	21
7.	Regjistër alfabetik për subjektet që mbartin detyrim për deklarimin e pasurive në I.L.D.K.P.	22
8.	Lista e zyrtarëve që mbartin detyrim për deklarimin vjetor të interesave më 31 dhjetor të çdo viti	23
9.	Lista e zyrtarëve që nuk kanë dorëzuar deklaratën e interesave deri më 31 mars të vitit	24
10.	Lista e zyrtarëve që kanë dorëzuar deklaratën e interesave	25
11.	Formati i vërtetimit për dorëzimin e deklarimit të interesave	26
12.	Guida	27-28



REPUBLIKA E SHQIPERISE
NSPEKTORATI I LARTE I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TE PASURIVE
Adresa: Rr."Reshit Çollaku" Tiranë.

KOMENTAR

Ligji Nr.9367, date 07.04.2005 "Per parandalimin e konfliktit te intersave ne ushtrimin e funksioneve publike" (hyre ne fuqi me 26 Maj 2005), gjate zbatimit konkret te tij kane dale disa probleme te cilat kane nevoje per interpretim dhe sqarim te metejshem.

Titullare institucionesh, autoritete e struktura perqejuese po te institucioneve publike kane kerkuar zgjidhje lidhur me problemet qe ndikojne drejtpersedrejtji ne parandalimin e konfliktit te interesave.

I.L.D.K.P.-ja cmon te perdore kete komentar ne sherbim te unifikimit ligor dhe respektimit te ketij ligji.

Probleme te ngritura:

1. A konsiderohen anëtare te organeve drejtuese, ne funksion te kufizimeve ne nenet 27-33 te Ligjit Nr.9367 dt 07.03.2005, ortaket dhe aksioneret ne shoqerite tregtare.

Pergjigje: Sipas ligjit për shoqërítë tregtare, ortakët që përfaqësojnë pjesë në kapital, ose asambleja e ortakëtve janë organe të shoqërive tregtare por jo organe drejtuese të saj. Ne funksion te kufizimeve të parashikuara në nenet 27-33 te ligjit nr.9367, datë 07.03.2005, do të konsiderohen organe drejtuese të shoqërive tregtare apo fitimprurëse "Administratorët" në një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe "Këshilli Drejtues dhe Bordi i Drejtoreve" në një shoqëri anonime ose aksionere.

2. A perben konflikt interesash zotrimi ne menyre aktive i aksioneve apo pjeseve ne kapital ne nje shoqeri tregtare, nga Kryetari i Bashkise, Komunes a Këshillit të Qarkut kur:

- a- Shoqëria ushtron aktivitet brenda juridiksonit te bashkise, komunes a qarkut;
- b- Shoqëria ushtron aktivitet jashtë juridiksonit te bashkise, komunes a qarkut;

Pergjigje: Kufizimet e interesave për funksionin e kryetarit të Bashkisë, Komunës apo Këshillit të Qarkut përcaktohen ne nenin 29, te ligjit nr.9367, datë 07.04.2005 si vijon:

Kryetari i bashkisë, i komunës dhe i këshillit të qarkut:

a) nuk mund të jenë drejtues ose anëtarë të organeve drejtuese të organizatave fitimprurëse, që ushtrojnë veprimtari brenda territorit të juridiksonit të tij;



b) nuk mund të ushtrojnë veprimitari private, që krijon të ardhura në formën e personit fizik tregar, ortakëri personash fizikë tregtarë të çdo forme, profesione të lira të avokatisë, noterisë, ekspertit të licensuar, si dhe të konsulentit, agjentit a përfaqësuesit të organizatave, të përcaktuara në shkronjën "a" të këtij nenit dhe nuk mund të jenë të punësuar, me kohë të plotë, në një detyrë tjetër.

Pra është e qartë se per kryetaret e Bashkive, Komunave a Këshillave të Qarqeve nuk ka kufizim ne zoterimin ne menyre aktive te aksioneve ose pjesave ne kapital ne shoqerite tregtare.

3. Zyrtarit publik X, sipas funksionit që mban, nuk i lejohet te jete drejtues ose anëtar i organeve drejtuese të organizatave fitimprurese, por i lejohet te zoteroje ne menyre aktive, aksione ose pjesë në kapital. Aktualisht zyrtari X eshte drejtues i shoqërisë "X" sh.p.k dhe sipas kërkesave të ligjit do të largohet nga ky funksion drejtues i shoqërisë për të shmangur konfliktin e interesit. A mundet që personi X me cilësinë e ortakut të shoqërisë te emërojë si drejtues te saj, pjesëtar te familjes së tij.

Pergjigje: Prania e interesave ne personat e lidhur me zyrtarin dhe kufizimet e tyre rregullohen sipas parashikmeve të bëra në nenin 35, te ligjit nr.9367, datë 07.04.2005. Kjo dispozitë ka përcaktuar disa kufizime për personat e lidhur me zyrtarin publik që ka të bëjë me mënyrën e administrimit të aksioneve në një shoqeri tregtare, pjesë në kapital apo veprimet si person fizik. Ne kete dispozite nuk janë parashikuar ndalesa qe lidhen me administrimin e një shoqerie. Per rrjedhoje anetari i familjes se zyrtarit X, mund te jete drejtues i një shoqerie tregtare.

4. A mundet që eprori apo një organ epror te kerkonte nga vartësi i drejtpërdrejtë deklarimin e interesave të tij private, sipas percaktimeve te bera ne nenin 5 te ligjit.

Pergjigje: Bazuar ne pikën 2 te nenit 7 te ligjit, eprori nëse ai gjykon se për një cështje të caktuar apo nga informacioni që ai disponon, mund të ketë mundësi për rënien në konflikt të interesave të vartësit, ai mund t'i kerkonte këtij të fundit deklarimin e interesave të tij private me qëllim shmangjen dhe parandalimin e mundësisë për rënien në konflikt interesash.

5. Zyrtari X, ushton një funksion publik, ku sipas ligjit nuk i lejohet të ketë në mënyrë aktive, pjesë ne kapitale apo aksione ne një shoqeri fitimprurëse. A mund t'ja transferoje pjesën e tij të kapitaleve apo aksioneve, një të besuar, i cili mund të jetë ortaku i shoqërisë, një pjesëtar i familjes apo një person i cili është mik i ngushtë i zyrtarit X.

Pergjigje: Në pikën 1, shkronja c, paragrafi "i" dhe "ii" të nenit 38, te ligjit 9367, datë 07.04.2005, është përcaktuar se person i besuar nuk mund te jete bashkëshorti/ ja dhe prindërit e tij/saj, fëmijët në moshë madhore dhe bashkëshortët e tyre, prindërit e zyrtarit, vëllezërit dhe motrat e tij dhe bashkëshortët e tyre, personat me miqësi të njohur me këtë zyrtar, një zyrtar apo person tjetër me lidhje varësie, qoftë edhe të tërthortë, për shkak të funksionit publik me zyrtarin në fjalë, një person fizik tregtar, qoftë njëri nga personat e sipërpërmendur, një shoqëri, ku zyrtari

zotëron, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, sipas kuptimit të nenit 25 të këtij ligji, aksione a pjesë në kapital, një organizatë jo fitimprurëse, në të cilën zyrtari ka pasur ose ka marrëdhënie interesë të çfarëdo lloji. Për rrjedhojë zyrtari X nuk mund të caktojë një të besuar i cili është ortak me të në një shoqëri ku ka pjesë kapitalesh apo aksione, një person të familjes apo një person i cili është mik i ngushtë i tij.

6. Personi X është i regjistruar si person fizik me fushë veprimtarie tregtare farmaci. Më pas personi X zgjidhet deputet në Kuvendin e Shqipërisë. Në bazë të ligjit a mundet që ky person të vazhdojë ushtrimin e aktivitetit të tij tregtar si person fizik.

Pergjigje: Ne nenin 28 te ligjit nr.9367, datë 7.4.2005 jepen kufizimet per parandalimin e rasteve te vecanta te konfliktit te vazhdueshem te interesave për deputetin. Ne shkronjen "b" te ketij nenii thuhet se deputeti nuk mund te ushtroje veprimtari private, qe krijon te ardhura ne formen e personit fizik tregtar. Në këto kushte ligji ka ofruar edhe menyrën e zgjedhjes së rasteve kur evidentohen rastet e konfliktit të interesave. Në zbatim të neneve 37 dhe 38 te ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, zyrtari duhet te heq dorë nga angazhimi privat dhe duhet ta mbyllë aktivitetin e tij privat të regjistruar në formën e personit fizik. Ne kete rast nuk behet fjale per tjetersim apo transferim aksionesh tek nje person i besuar, sepse nuk kemi te bejme me shoqeri tregtare ne formen e aksioneve apo ortakerise por me person fizik tregtar.

7. Pyetje: Zyrtari publik X emërohet në detyrën e ministrit. Në të njëjtën kohë babai i bashkëshortes së tij është aksioner ne shoqerine tregtare sh.a. me një perqindje te caktuar te aksioneve. A perben mbajtja e aksioneve konflikt interesë për zyrtarin X dhe nese po menyra e zgjidhjes.

Pergjigje: Sipas nenit 35 te ligjit, për efekt të kufizimeve që vijnë si pasojë e ushtrimit të një funksioni publik, do të konsiderohen si persona të lidhur bashkëshorti/ja, fëmijët në moshë madhore, prindërit e zyrtarit e të bashkëshortit/es. Në rast se aksionet apo pjesët në kapital janë të regjistruara në emrin e personit të lidhur, ato vlerësohen njëlloj si të ishin të regjistruara në emër të vetë zyrtarit dhe personit të lidhur i kufizohen të drejtat pasurore për to, në të njëjtën masë dhe mënyrë si në rastin e vetë zyrtarit. Për të bërë të mundur shmangjen dhe zgjedhjen e këtij rasti në zbatim të neneve 37, e 38 të ligjit, duhet të ndjekë këto hapa:

- a- **Duke i transferuar aksionet tek nje i besuar, duke mbajtur parasysh kufizimet qe jepen ne piken 1, shkronja c, te nenit 38.** (I besuari nuk mund te jete bashkeshorti/ ja, dhe prinderit e tij/saj, femijet ne moshe madhore dhe bashkeshoret e tyre, prinderit e zyrtarit, vellezerit dhe motrat e tij dhe bashkeshoret e tyre, personat me miqesi te njohur me kete zyrtar, nje zyrtar apo person tjeter me lidhje varesie, qofte edhe te terthorte, per shkak te funksionit publik me zyrtarin ne fjale);
- b- **Duke i tjetersuar, shitur nje personi tjeter, dhe per bleresin duhen mbajtur parasysh kufizimet qe jepen ne piken 2 te nenit 38 te ligjit (kufizimet per blersin e aksioneve janë te njejtë me ato per te besuarin, si me siper);**
- c- **Duke u larguar nga ushtrimi i funksionit publik.**

8. Shoqeria tregetare "X" sh.p.k. ka lidhur një kontrate shërbimi me afat tre vjet per pastrimin dhe gjelberimin e një qyteti, në fillim të vitit 2004. Pjesëtarë në kapitalin e kësaj shoqërie është edhe babai i bashkëshortes së kryetarit të Bashkisë së atij qyteti ku është lidhur kontrata e shërbimit. Me hyrjen në fuqi te ligjit nr.9367, datë 07.05.2005, a përbën kjo kontratë një konflikt interes i privat për kryetarin e Bashkisë në ushtrimin e detyrës së tij publike.

Pergjigje: Ne pikën 1 e 2 te nenit 21 te ligjit nr.9367 datë 07.04.2005, janë vendosur kufizime për lidhjen e kontratave ndërmjet institucioneve publike dhe personave fizik apo shoqërive tregtare të cilat kanë lidhje me zyrtarin publik që drejton atë institucion me të cilin lidhet kontrata. Konkretnisht:

1. Nuk mund të lidhë kontratë me asnjë institucion publik:

- a) asnjë person fizik, sipas rastit, në kuptimin civil ose tregtar, kur ai përkon me një person, i cili është zyrtar në funksionet e përcaktuara në seksionin 2 të këtij kreu;
- b) asnjë shoqëri tregtare, ortakëri ose shoqëri e thjeshtë, në lidhje me të cilën.zyrtari, që u përket kategorive të përmendura në shkronjën "a" të pikës 1 të këtij neni, zotëron, në mënyrë aktive ose pasive, aksione ose pjesë në kapital në çfarëdo sasi.

2. Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit ose nënkyetarit të bashkisë, komunës ose këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues i një njësie të qeverisjes vendore, sipas kuptimit relativ të këtij termi për këto njësi, ndalimi i kontratave, sipas shkronjave "a" dhe "b" të pikës I të këtij neni, zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave me bashkinë, komunën ose qarkun, ku ushtron funksionet zyrtari, si dhe në rastin e lidhjes së kontratave me institucione publike, në varësi të bashkisë, komunës ose qarkut. Për këta zyrtarë dhe për kufizimin e kësaj pike, në kuptim të shkronjës "b" të pikës 1 të këtij neni, ndalimi zbatohet për çdo sasi të zotërimit të aksioneve ose pjesëve në kapital dhe për çdo nivel të ardhurash të përgjithshme bruto vjetore të shoqërisë.

3. Pavarësisht përcaktimese në pikat I dhe 2 të këtij neni, nuk mund të lidhet kontratë ndërmjet institucionit publik, në të cilin ushtron funksionet zyrtari dhe çdo institucion publik; në varësi të këtij institucioni nga njëra anë, dhe një personi fizik, civil ose tregtar, ose person juridik, si dhe çdo ortakëri ndërmjet këtyre personave, nga ana tjetër, kur:

- a) zyrtari ka kompetencë thelbësore dhe përcaktuese në vlerësimin e ofruesve dhe të ofertave
- dhe përcaktimin e termave të kontratës;
- b) zyrtari ka interesa privatë, sipas përcaktimese të nenit 37 të Kodit të Procedurave Administrative dhe/ose të nenit 709 të Kodit Civil.

Në këtë rast jemi përpara tre menyra zgjidhjesh:

I-Zgjidhje e kontrates me shoqerine tregtare "X" sh.p.k dhe fillim i procedurave per perzgjedjen e një kontraktori të ri, ku shoqeria "X" dhe te përjashtohet nga konkurimi;



II-Shitja e Shpk "X", por bleresi, bazuar ne nenin 38 pika 2, ka këto kufizime: nuk mund te jete bashkeshorti/ja dhe prinderit e tij/saj, femijet ne moshe madhore dhe bashkeshoret e tyre, prinderit e zyrtarit, vellezerit dhe motrat e tij dhe bashkeshoret e tyre, personat me miqesi te njohur, nje zyrtar apo person tjeter ne lidhje vartesie qofte edhe te terthorte, per shkak te funksionit publik me zyrtarin ne fjalë.

Procedurat e evidentimit te subjekteve qe mbartin detyrim per deklarim te pasurise.

a. ne rastet e deklarimit para fillimit te punes:

Ne baze te nenit 15, pika 5, germa "a" te ligjit nr.9367, date 07.04.2005 deklarata duhet te plotesohet brenda 30 diteve nga data e fillimit te punes. Ne te duhet te pasqyrohen pasurite, detyrimet financiare, interesat e percaktuara te grumbulluara deri ne diten e fillimit te detyres. Deklarata duhet te paraqitet ne autoritetin pergjegjes te institucionit dhe ky i fundit brenda 15 diteve duhet ta dorezoje ate ne I.L.D.K.P.

b. ne rastet kur subjekti ne detyre ka pas bere deklarimin e pare te pasurise ne institucionin ku kryen funksionin dhe me pas merr nje funksion publik sipas te cilit deklarata e pasurise se tij duhet t'i kaloje per kontroll I.L.D.K.P.

Subjekti dhe Autoriteti Përgjegjës duhet të njoftojnë I.L.D.K.P. duke shoqëruar për këtë lëvizje deklaratën e pasurise nga autoriteti pergjegjes i institucionit tek I.L.D.K.P.

c. Ne rastet e transferimit te subjekti nga nje institucion ne institucionin tjeter, ku perseri mbetet subjekt i deklarimit te pasurise

Subjekti duhet të njoftojë I.L.D.K.P. për lëvizjen e tij nga institicioni në institucion tjeter dhe zyrtatisht kjo duhet bërë nga Autoriteti Përgjegjës i institucionit të parë.

9. Subjektet qe deklarojne para fillimit te punes gjate vitit 2005 dhe që deklarojne gjendjen e pasurise dhe te interesave ne daten e fillimit te punes, kur do te bejne deklarimin vjetor.

Pergjigje: Deklarimi vjetor do të bëhet si për gjithë subjektet e tjerë brenda dates 31 mars te cdo viti, por subjekti në fjalë do deklarojë ndryshimet e ndodhura nga momenti që ka bërë deklarimin me marrjen e funksionit deri më 31 Dhjetor te vitit parandhes.

10. A kanë konflikt interes i pjestare te nje familje, te cilët punojnë ne te njejtën Drejtori te nje institucioni, me pozicione te njëjta por pa lidhje vartesie ndërmjet tyre?

Pergjigje: Duhet patur parasysh se nëse dy personat që kanë lidhje familjare ndërmjet tyre, nuk kanë marrdhnie vartesie dhe vlerësimi pune, pra interesa personale ndërmjet tyre, atëherë nuk jemi përpara ndonjë rasti konflikti. Megjithatë është detyrë e eprorit që të shikojë dhe rregullojë përshkrimin e detyrës dhe punës së këtyre zyrtarëve publik me qëllim shhangjen e cdo lloj interesi apo lidhjeje që mund të ketë ndërmjet tyre.

11. Zyrtaret qe jane ne periudhe prove, por qe per shkak te funksionit perfshihen ne detyrimin per deklarim te interesave do ta bejne deklarimin e pasurise duke filluar nga periudha e proves apo pas perfundimit te saj.

Pergjigje: Zyrtari qe mbart detyrim per deklarim te interesave do te plotesoje formularin e deklarimit per gjendjen e interesave deri ne daten e fillimit te detyres nga periudha e proves e ne vazhdim dhe ta dorezoje ate brenda 30 diteve prane Autoritetit Pergjegjes te institucionit ku ushtron funksionet publike.

12. Ne nje institucion kush nga zyrtaret do te plotesoje autorizimin sipas nenit 10 pika 2 te ligjit nr 9367 date 07.04.2005.

Pergjigje: Dhenien e autorizimit ne favor te institucionit publik, nepermjet te cilit ai e autorizon kete institucion te kryeje kontroll dhe te siguroje te dhena vetjake per zyrtatin, eshte i detyruar ta beje cdo zyrtar, jo me vone se 30 dite nga hyrja ne fuqi e ligjit nr. 9367, date 07.04.2005 ose nga data e fillimit te detyres ne nje institucion publik. Modeli i autorizimit u eshte derguar te gjithe institacioneve shteterore nga Inspektori i Pergjithshem i I.L.D.K.P. me Nr.877.prot, date 24.06.2005. (Ne komentar do te gjeni nje kopje te ketij autorizimi).

13. Kush e përfiton shtesën prej 15% mbi pagen mujore në autoritetin apo strukturen perqjegjese per parandalimin e konfliktit te interesave ne ushtrimin e funksioneve publike.

Pergjigje: Autoriteti përgjegjës për parandalimin, kontrollin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesave të zyrtarëve publikë në institucion, sipas nenit 41, pika 2, gërmë "b", konsiderohen drejtoret, njësitë e burimeve njerëzore apo njësitë e ngarkuara të ngritura posacërisht sipas mundësive të cdo institucion publik.

Autoriteti përgjegjës miratohet nga titullari i institucionit sipas dispozitës së sipërcituar si dhe të përcaktimit të bërë në Rregulloren e Brendshme "Për parandalimin e konfliktit të interesave të zyrtarëve që ushtrojnë funksione publike". Bazuar në nenet 10 dhe 11 të ligjit nr.9367, datë 07.4.2005, autoriteti përgjegjës në institucion luan rol aktiv në mbledhjen e informacioneve për interesat private të zyrtarit si dhe regjistron rast për rast konfliktet e interesave.

Për punën e kryer në shërbim të Inspektoratit të Lartë, bazuar në nenin 42, pika 3 të ligjit nr.9367, datë 07.4.2005 zyrtarët e këtyre autoritetave përfitojnë një shtesë prej 15% mbi pagën mujore.

Pra shtesa nuk jepet për gjithë veprimtarinë e Autoritetit Përgjegjës, por vetëm mbi punën e kryer në shërbim të Inspektoratit të Lartë.

Kryerja e veprimtarisë në përgjithësi ligjore e këtyre zyrtarëve është është pjesë përbërëse e vetë natyrës së funksionit të tyre.

14. Kur subjekti që deklaron pasurinë apo familjarët e tij (bashkëshorti/ja dhe fëmijët madhorë) kanë të regjistruar në organet gjyqësore dhe tatimore një aktivitet tregtar në emër të tyre, cfarë do të deklarojnë në deklaratën e pasurisë.

Pergjigje:a) Kur familjarët e zyrtarit (bashkëshorti/ja dhe fëmijët madhorë) janë ortakë në një shoqëri anonime (sh.a.) ata do të deklarojnë vlerën e shpenzuar për blerjen e aksioneve, shumën e parave që kanë përfituar nga ndarja e dividentit

(fitimin neto), paga apo shpërblime që mund të kenë patur nga kompania, si dhe shumën e parave që subjekti mund t'i ketë marrë kompanisë ose kompania mund t'i ketë marrë subjektit. Në deklaratë nuk do të deklarohet apo përshkruhet asnjë pasuri e luajtshme apo e paluajtshme që është e rregjistruar në emër të kompanisë.

b) Kur familjarët e zyrtarit (bashkëshorti/ja dhe fëmijët madhorë) janë ortakë në një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k.), subjektit do të deklarojnë vlerën e shpenzuar për blerjen e aksioneve të kapitalit themeltar të shoqërisë, fitimin e ndarë në fund të aktivitetit ekonomik të cdo viti, paga apo shperblime që mund te kene patur nga shoqeria, si dhe shumen e parave që subjekti mund t'i ketë marre shoqerise ose kur kjo e fundit mund t'i kete marre subjektit. Ne deklarate nuk do te deklarohet apo përshkruhet asje pasuri e luajtshme apo e paluajtshme që është e regjistruar në emër të kompanisë.

c) Kur subjekti është i rregjistruar në gjykatë si person fizik dhe në organet tatumore është i rregjistruar si biznes i vogël, atëherë ai duhet të deklarojë gjithë pasuritë e personit fizik si të ishin pasuri personale te vetë subjektit. Kështu psh. zyrtari apo subjekti do të deklarojë dyqan, magazinë apo pasuri të paluajtshme që ka të rregjistruar në emër të vet, fitimet e realizuara nga ky aktivitet pasi edhe ky është i rregjistruar në emër të subjektit etj..

15. Në rast se në një familje mbartin detyrimin për deklarim të interesave private më shumë se një subjekt (bashkëshorti/ja, fëmijët në moshë madhore) si do të veprohet.

Pergjigje: Në rastet kur njëri prej subjekteve (bashkëshorti/ja apo fëmija në moshë madhore) deklaron pranë Inspektoratit të Lartë (sipas përcaktimit në nenin 3 të ligjit nr.9049, datë 10.04.2003 dhe nenit 27 dhe 33 të ligjit nr.9367, datë 07.4.2005), deklaratës së këtij subjekti do t'i bashkëlidhet edhe deklarata e pasurisë së bashkëshortit/es apo fëmijëve në moshë madhore që janë në certifikatën e gjendjes familjare me subjektin. Autoriteti Përgjegjës i institucionit pranë të cilit subjekti depoziton deklaratën e pasurisë edhe të bashkëshortit/es apo fëmijëve në moshë madhore, i lëshon një vërtetim me shkrim i cili do të shërbejë për të dokumentuar këtë fakt pranë Autoritetit Përgjegjës të institucionit ku bëjnë pjesë familjarët e subjektit. Në këtë rast personat e tjerë të familjes janë të detyruar të njoftojnë menjëherë Autoritetin Përgjegjës të institucionit ku ata punojnë për këtë deklarim dhe t'i tregojnë vërtetimin përkatës. Autoriteti përgjegjës duhet që një fakt të tillë ta rregjistrojë menjëherë në rregjistrin alfabetik të subjekteve që deklarojnë pasurinë pranë tyre dhe të mbajnë një fotokopje të këtij vërtetimi.

Në vijim Inspektorati i Lartë do të vazhdojë të dërgojë spjegime dhe të ofrojë konsulencë të vazhdueshme për të gjitha problemet që mund të dalin gjatë procesit të deklarimit. Për cdo paqartësi, pyetje apo problem që mund të kini mund të drejtoheni në numrin e telefonit pa pagesë 0800 9999 ose në faqen e internetit me adresë Info: www.hidaa.gov.al.

MEMORANDUM BASHKEPUNIMI ndermjet INSPEKTORATIT TE LARTE TE DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TE PASURIVE dhe MINISTRISE SE PUNEVE TE JASHTME

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Ministria e Punëve të Jashtme, këtej e më poshtë referuar si "palët",

Me qëllim:

- realizimin e bashkëpunimit të ndërsjelltë ndërmjet dy palëve në luftë kundër korruptionit dhe krimit të organizuar;
- përshtypimin e procedurave ligjore për verifikimin dhe hetimin e rasteve të pasurive të paligjshme jashtë vendit;
- bashkërendimin e veprimeve nëpërmjet përfaqësive diplomatike të Republikës së Shqipërisë dhe institucioneve të huaja që realizojnë procesin e luftës kundër korruptionit;

Ranë dakord si vijon:

Për qëllimet e këtij Memoradumi termi "MPJ" nënkupton Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe termi "ILDKP" nënkupton Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive.

Të dy -palët, në bazë te shkronjës "ç;" të nenit 17 të Ligjit nr.9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike", do të angazhohen për një bashkëpunim konkret me qëllim rritjen e luftës kundër korruptionit dhe krimit ekonomik.

ILDKP, në rastet e marrjes së informacioneve si dhe nga të dhënat e paraqitura në dokumentin "deklaratë pasurie" për pasuri jashtë vendit të subjekteve të ndryshëm, në zbatim të pikës 5 të nenit 14 të Ligjit nr.9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", do t'i drejtohet MPJ-së me kërkesë për të bashkëpunuar në mbledhjen e provave (dokumenteve shkresore) lidhur me verifikimin e të dhënavë të deklaratës së pasurisë.

Ky bashkëpunim do të realizohet nëpërmjet përfaqësive diplomatike të Republikës së Shqipërisë, të akredituar pnanë vendit ku deklarohet ekzistencë e pasurisë së subjekteve të ndryshme. Në këto raste, ILDKP-ja do të vëré në dispozicion të përfaqësisë diplomatike përkatëse një autorizim që lejon mbledhjen e të dhënave dhe dokumenteve të ndryshme të pasurisë së subjektit, kudo ku ato ndodhen në shtetin ku është akredituar përfaqësia diplomatike.

MPJ nëpërmjet rrugëve diplomatike do të angazhohet për mbledhjen e informacioneve të kërkua, pranë të gjitha organeve publike dhe private, të shteteve ku përfaqësitetë diplomatike shqiptare janë akredituar, në përpunje me legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë dhe të vendeve përkatëse, si dhe me aktet ndërkombëtare shumëpalëshe.

MPJ, në bazë të kërkesës së ILDKP-së, gjithashtu do të angazhohet për krijimin e kontakteve me institucionet homologe të ILDKP-së në shtete të tjera dhe për përfundimin e marrëveshjeve dypalëshe të bashkëpunimit, me qëllim koordinimin dhe mbledhjen e të dhënave personale që lidhen me pasuritë e paligjshme të zyrtarëve publikë dhe atyre të zgjedhur.

Ky Memorandum Bashkëpunimi hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit.

Ky Memorandum Bashkëpunimi hartohet në dy kopje origjinale në gjuhën shqipe, njëra prej të cilave depozitohet në MPJ dhe kopja tjetër depozitohet në ILDKP.

Ky Memorandum Bashkëpunimi u nënshkrua në Tiranë, më datë 9 nëntor 2005.

Për Inspektoratin e Lartë të Deklarimit
dhe Kontrollit të Pasurive

INSPEKTORI I PERGJITHSHEM
FATMIRA LASKA

Per Ministrinë e Puneve
te Jashtme

MINISTRI
BESNIK MUSTAFAJ



PROJEKTRREGULLORE

“Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”

I- **Baza ligjore dhe fusha e zbatimit**

- 1- Kjo rregullore hartohet dhe miratohet në bazë të nenit 46 paragrafi 1të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”. Në rregullore zbërthehen dhe përcaktohen hollësi më të qarta dhe më të plota në lidhje me zbatimin e kërkesave të ligjit në kushtet e institucionit——
- 2- Qëllimi i kësaj rregulloreje është garantimi i një vendimmarrjeje transparente, të paanëshme, në mbështetje të realizimit të objektivit dhe detyrave kryesore të institucionit——, në interesin më të mirë të mundshëm të publikut e të besimit të tij ndaj institucionit të ——, nëpërmjet parandalimit të konfliktit ndërmjet interesave publike dhe atyre private të një zyrtari në ushtrimin e funksioneve të caktuara vendimmarrëse në institucionin——
- 3- Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave dhe procedurave për identifikimin, deklarimin, regjistrimin, trajtimin, zgjidhjen dhe dënimin e rasteve të konfliktit të interesave në kushtet e institucionit——

II- **Ngritura dhe funksionimi i strukturës përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike.**

- 1- Autoriteti përgjegjës për zbatimin e këtij ligji në institucionin—— janë:
 - a- Titullari i institucionit — dhe eprorët e zyrtarëve sipas hierarkisë;
 - b- Drejtoria e Burimeve Njerëzore në institucionin——;
 - c- Institucionet eprore ——;
- 2- Institucionet e vartësisë:
 - a- të cilat kanë ngritur strukturë përgjegjëse janë —————
 - b- të cilat nuk kanë ngritur strukturë përgjegjëse janë————

Për institucionet e vartësisë që nuk kanë ngritur strukturë përgjegjëse detyrimet ligjore do të ndiqen e zbatohen nga Autoriteti përgjegjës i institucionit——

- 3- Autoriteti përgjegjës i përcaktuar në gërmën “b” mbështet dhe kryen detyrat e ngarkuara nga Inspektori i Përgjithshëm, për lehtësimin dhe zhvillimin e frytshëm të procesit të deklarimit periodik të interesave.

Për punën e kryer, në shërbim të Inspektoratit të Lartë, Autoriteti përgjegjës përfiton një shtesë 15 % mbi pagën mujore.

- 4- Autoriteti përgjegjës në zbatim të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 është i autorizuar që në mënyrë aktive në emër të institucionit —:
- ☞ të mbledhë, nga burime të ligjshme të informacionit të dhëna për interesat private të një zyrtari;
 - ☞ të pranojë informacionet e siguruara në mënyrë të ligjshme;
 - ☞ të verë në dijeni zyrtarin për informacionet e siguruara për të;
 - ☞ t'i japë mundësi zyrtarit të provojë të kundeërtën, nëse ky i fundit e kërkon një gjë të tillë;
 - ☞ të bëjë regjistrimin e interesave private të zyrtarit; jo më vonë se 30 ditë nga hyrja në fuqi e këtij ligji ose nga data e fillimit të marrëdhënive të puneës ne një institucion publik të njoftojë zyrtarin, i cili është i detyruar të lëshojë një autorizim në favor të institucionit publik ku ushtron funksionet nëpërmjet të cilit e autorizon këtë institucion të kryejë kontroll dhe të sigurojë të dhëna vetjake për zyrtarin, kudo ku ato janë regjistruar, autorizm i cili ka të njëjtën vlerë edhe për cdo institucion epror;
 - ☞ Për çdo rast të shfaqjes së një konflikti rast për rast të interesit, regjistrohet identiteti i zyrtarit, interesat private të tij, shkak për një konflikt interes, thelbi i konfliktit, palët e interesuara, burimi i të dhënave, mënyra e marrjes dhe verifikimit të tyre, si dhe vendimi që është marrë, mbështetur në këto të dhëna, përfshire edhe vendimet e marra nga eprorët, institucionet eprorë ose nga gjykata;
 - ☞ I gjithë dokumentacioni, që ka të bëjë me deklarimin dhe kontrollin e pasurive, arkivohet sipas rregullave dhe ruhet për një periudhë 10-vjeçare.

III- Identifikimi dhe regjistrimi i interesave në kushtet e konfliktit rast për rast të interesave.

Përkufizime:

Konflikt rast për rast interesit është gjendja, me konflikt

Interesi që shfaqet rast për rast dhe lidhet me një vendimmarrje të veçantë në rastet si vijon:

- ☞ **Konflikt faktik i interesit** është gjendja në të cilën interesat private të zyrtarit ndikojnë, kanë ndikuar ose mund të kenë ndikuar në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të zyrtarit.
- ☞ **Konflikt në dukje i interesit** është gjendja në të cilën interesat private të zyrtarit duken në pamje ose në formë sikur kanë ndikuar ndikojnë ose mund të ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave apo përgjegjësive të zyrtarit, por në fakt ndikimi nuk ka ndodhur, nuk ndodh ose nuk ka mundësi të ndodhë.
- ☞ **Konflikti i mundshëm i interesit** është gjendja në të cilën interesat private të zyrtarit mund të shkaktojnë në të ardhmen shfaqjen e konfliktit faktik ose në dukje të interesit nëse zyrtari përfshihej në detyra apo përgjegjësi të caktuara.

- 1- Bazuar në nenin 4 dhe 10 paragrafi 2 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 në kushtet e _____ zyrtarët që do të plotësojnë autorizim për verifikim të konfliktit të interesave rast për rast do të jenë: (sipas funksioneve)



- 2- Në kushtet e institucionit — kuptimi i vendimmarjes për një akt dhe kompetencës thelbësore e përcaktuese të një zyrtari sipas funksioneve të sipërcituara do të jenë si vijon:
- 3- Në kushtet e institucionit — nënlojet e interesave, ose interesat konkrete që mund të bëhen shkak për lindjen e konfliktit të interesave, si dhe masa e kufizimit të tyre do të jenë:
- 4- Kriteret dhe treguesit për të mundësuar matshmërinë dhe vleresimin sa më të qartë e objektiv të kryerjes në mënyrë të drejtë të detyrave dhe përgjegjësive nga një zyrtar, per parandalimin e konfliktit të interesave janë:
- 5- Procesi i identifikimit dhe regjistrimit të interesave private të zyrtarëve, të lidhur me konfliktin rast për rast të interesit në institucionin — do të realizohet si vijon:
- 6- Çdo zyrtar apo subjekt që ofron informacion të bazuar në rastet e konfliktit të interesave të padeklaruara nga subjektet që mbartin detyrim përfiton sipas rastit një mbrojtje të veçantë administrative.
- 7- Parandalimi i llojeve të veçanta të konfliktit rast për rast të interesit do të realizohet si vijon:
- a- Çdo zyrtar në ushtrimin e kompetencave apo kryerjen e detyrave të tij publike, në bazë të njohjes së tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë **vetëdeklarim** paraprak, rast për rast të egzistencës së interesave të tij private, që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti interesit.
 - b- Deklarimi rast për rast i interesave private bëhet çdo herë nga zyrtari, kur kjo **kërkohet** nga eprori ose institicioni epror.
- 8- Kufizime të interesave private të zyrtarit për parandalimin e konfliktit rast për rast të interesave për çështje të veçanta do të jenë si vijon:
- a- Ndalimi i lidhjes së kontratave
Të përcaktohen funksionet dhe rastet konkrete të institucionit përkatës —
 - b- Ndalime në sigurimin e të ardhurave për shkak të funksionit të veçantë.
Të përcaktohen rastet dhe funksionet e veçanta në institucion —
 - c- Ndalimi i marrjes së dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale.
Të përcaktohen procedura për zbatimin e këtij kufizimi në institucion —
 - d- Rrethi i personave të lidhur me zyrtarin në zbatim të ndalimeve të sipershënuara përbëhen nga bashkeshorti/ja, fëmijët në moshë madhore dhe prindërit e zyrtarit e të bashkëshortit/es, si dhe çdo person fizik ose juridik, i cili në lidhje me dhuratën, favorin, premtimin ose trajtimin preferencial, luan rolin e ndërmjetësit a të shkembyesit të interesave të lindur nga ky veprim.

- 9- Në kushtet e institucionit — përveç kufizimeve të interesave private të zyrtarit të përcaktuara si më sipër do të jenë edhe këto kufizime:

a) _____
b) _____

IV- Identifikimi dhe regjistrimi periodik i interesave private.

- 1- Bazuar në nenin 3 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 dhe në nenet 27 deri 33 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 nga Autoriteti përgjegjës i institucionit — të bëhet regjistrimi i zyrtarëve që mbartin detyrim për deklarim periodik të interesave në regjistrin themeltar sipas formatit të miratuar nga Inspektori i Përgjithshëm me urdhër nr. 2, datë 13.1.2004.

a- Për zyrtarin që fillon për herë të parë punë se bashku me aktin e emërimit bashkëlidhet edhe njoftimi për detyrimin për deklarim dhe një kopje e deklaratës për t'u plotësuar. Deklarata duhet të dorëzohet në zyrën e Autoritetit Përgjegjës të institucionit brenda 30 ditëve nga data e fillimit të punës. Autoriteti përgjegjës brenda 15 ditëve nga data e dorëzimit nga të deklaratës nga zyrtari duhet ta dorezoje ate ne ILDKP

b- Për zyrtarin që largohet nga funksioni që mbart detyrim për deklarim së bashku me aktin e largimit nga puna bashkëlidhet edhe njoftimi për detyrimin për deklarim dhe një kopje e deklaratës për t'u plotësuar. Deklarata duhet të dorëzohet brenda 15 ditëve nga data e largimit nga funksioni. Autoriteti përgjegjës brenda 15 ditëve nga data e dorëzimit të deklaratës duhet ta dorëzojë atë në ILDKP.

c- Në deklarimin periodik jepen vetëm ndryshimet e ndodhura në interesat private, të deklaruara me parë, interesat e lindura gjatë vtitit që deklarohet dhe çdo e ardhur e fituar gjatë gjithë vtitit për të cilin bëhet deklarimi. Zyrtarët që mbartin detyrim për deklarim periodik detyrohen të paraqesin deklaratën e tyre, të mbyllur në zarf deri më 31 mars të çdo viti, pranë autoriteti përgjegjës të institucionit —, gjendjen e interesave private (të pasurive, të detyrimeve financiare, të të ardhurave të përfituar, të dhuratave, si dhe të interesave të lidhura me biznesin) me 31 dhjetor të vtitit paraardhës.

Autoriteti përgjegjës brenda datës 15 prill të çdo viti dorëzon deklaratat e pasurisë në ILDKP.

d- Autoriteti përgjegjës identifikon në çdo rast zyrtarët që mbartin detyrim për deklarim të pasurive dhe për rastet e mos deklarimit njofton ILDKP-në brenda 15 ditëve nga afati që duhej dorëzuar deklarata e pasurisë nga zyrtari, duke evidentuar edhe shkaqet e mos dorëzimit të deklaratës së pasurisë.

e- Autoriteti përgjegjës duhet t'i japë të gjitha këshillat e nevojshme deklaruesit për plotësimin e deklaratës dhe t'i bëhen të njoitura rrjedhimet që mbart deklarimi i rremë.

f- Autoriteti Përgjegjës i institucionit — brenda datës 15 janar të çdo viti dërgon në ILDKP, listën emërore të zyrtarëve që mbartin detyrim për deklarim të interesave periodike, të miratuar nga titullari i institucionit.

V-Sanksionet

- 1 Çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë sipas kufijve të përcaktuara në nenin 44 të ligjit.



- 2- Çdo shkelje e detyri me të përcaktuara në këtë ligj, nga zyrtarët përbën shkelje disiplinore, pavarësisht nga përgjegjësia penale apo administrative. Masat disiplinore zbatohen në perputhje me ligjet që rregullojnë marrëdhieniet e punës dhe statusin e zyrtarit në institucion —.
- 3- Bazuar në nenin 45 pika 4 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, mosdhënia e autorizimit, sipas pikës 2 të nenit 10 dhe pikës 5 të nenit 14 të ligjit, sjell ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, sipas procedurave të përcaktuara në legjislacionin, që rregullon marrëdhieniet e punës.
- 4- Bazuar në nenin 5 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, refuzimi për deklarim nga zyrtari sjell humbjen e vendit të punës dhe ndëshkimin në përputhje me Kodin Penal.

Kjo rregullore hyn ne fuqi më _____

TITULLARI I INSTITUCIONIT

DEKLARIM

RAST PER RAST I INTERESAVE PRIVATE TE ZYRTARIT NE USHTRIMIN E FUNKSIONEVE PUBLIKE

☞ **Kush mbart detyrim per deklarim:**

Te gjithe zyrtaret e percaktuar ne nenin 4 te ligjit nr 9367 date 07.04.2005 si dhe ne Regulloren e brendshme te institucionit.

☞ **Llojet e deklarimit:**

- 1- Vetdeklarim paraprak, rast per rast te egzstences se interesave private, qe mund te behen shkak per lindjen e nje konflikti interes
- 2- Deklarim rast per rast te interesave private te nje zyrtari kur kerkohet nga eprori ose institucioni epror.

☞ **Te dhena personale:**

Emri – Atesia – Mbiemri – Funksioni – Institucioni.

☞ **Lloji i deklarimit: (vendos X në kutizën për llojin e deklarimit)**

- Me kerkese te _____
 Vetedeklarim

**Vertetoj se deklarimet e bera ne vijim nga une jane te plota, te verteta, te sakta
dhe mbaj perjegjesi ligjore per vertetesine e tyre.**

1- Pershkrimi i hollesishem i interesave private qe behen shkak per nje konflikt interes:

2- Permbajtja e kufizimit ligjor ne ushtrimin e funksioneve publike qe behet shkak per nje konflikt intersi:

3- Menyra e zgjidhjes se konfliktit te interesave:

Data e dorezimit te deklarates _____

Emer Mbiemer, nenshkrimi



Institucioni.....
Regjistri i konfliktit të interesave

NR	EMRI I ZYRTARIT FUNKSIONI	DATA E DEKLARI- MIT	PERSHKRIMI DETAJUARI PALETË INTERESUARA	HAPAT QE DO NDERMERREN PER ZGJDHJENË KONFLIKTIT VENDIMETE MARRA	BURIMI INFORMACIONIT	NENSHKRI- MI

REGJISTRI THEMELTAR ALFABETIK PER SUBJEKTET QE MBARTIM DETYRIM PER DEKLARIM TE PASURVENE ILDKH

REGJISTRI THEMELTAR ALFABETIK PER SUBJEKTET QE MBARTIM DETYRIM PER DEKLARIM TE PASURIVE NE ILDKP

INSTITUCIONI AUTORITETI PERGJEGJES PER PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TE INTERESAVE

LISTA E ZYRTAREVE QE MBARTIN DETYRIM PER DEKLARIM VJETOR TE INTERESVE ME 31 DHJETOR TE CDO VITI

me

P/Autoritetin Pergjegjes

(_____)

Shënim : Dergohet brenda dates 15 Janar te çdo viti, lista e zyrtareve qe mbartin detyrim per deklarim vjetor te interesave, me shkresë përcjellëse të firmosur nga titullari institucionit.

INSTITUCIONI AUTORITETI PERGJEGJES PER PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TE INTERESAVE.

LISTA E ZYRTAREVE QE KANE DOREZUAR DEKLARATEN E INTERESAVE DERI ME 31 MARS TE VITIT _____

me _____

P/Autoritetin Pergjegjes

(_____)

Shenim : Dergohet brenda dates 15 Prill te cdo viti, lista e zyrtareve qe kane dorezuar deklaraten e interesave deri me 31 Mars te cdo viti

INSTITUCIONI AUTORITETI PERGJEGJES PER PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TE INTERESAVE

me

P/Autoritetin Pergjegjes

(_____)

Shenim : Dergohet brenda dates 15 prill te cdo viti, lista e zyrtareve qe mbartin detyrim per deklarim vjetor te interesave dhe nuk e kane dorezuar ate.



**INSTITUCIONI
AUTORITETI PËRGJEGJËS PËR PARANDALMIN E
KONFLIKTIT TË INTERESAVE**

me _____

VËRTETIM

Z. _____ me funksion _____ në
institucionin _____ më datë _____ ka dorëzuar
deklarimin e interesave për periudhën _____
Së bashku me deklarimin e vet, në zarf ka vendosur edhe deklarimin
e pjestarit të familjes z. _____ i cili mbart detyrim për
deklarim të interesave në institucionin _____

P/Autoritetin përgjegjës

(_____)



GUIDË

për KONFLIKTIN E INTERESAVE

Ligji shqiptar Nr. 9367, datë 7.04.2005, "Për Konfliktin e Interesave", hyri në fuqi më datë 26 maj 2005.

Në rastet e thyerjes dhe mos zbatimit korrekt të këtij
Ligji janë parashikuar penalitete

Çfarë është një Konflikt Interesash?

Një "Konflikt Interesash" është një situatë konflikti që ndodh tek një zyrtar mes detyrës së tij publike dhe interesave private gjatë ushtrimit të detyrës.

Kjo ndodh kur një zyrtar ka direkt ose indirekt interesë private të cilat ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në mënyrë jo korrekte, me përgjegjësinë dhe në detyrën e tij publike.

Konflikti mund të jetë rast pas rasti ose i vazhdueshëm.

Interesat private përfshijnë:

1. Të drejta dhe detyrime pasurore të çdo lloj natyre.
2. Çdo marrëdhënie tjeter juridikocivile.
3. Dhurata, pretime, favore, trajtime preferenciale.
4. Negocime të mundshme përpunësim në të ardhmen nga ana e zyrtarit.
5. Angazhime në veprimtari private.
6. Marrëdhënie familjare, të bashkëjetesës, të komunitetit, etnike.

Kush përfshihet

Ky ligj përfshin të gjithë zyrtarët e zgjedhur dhe nënpunës të nivelit të lartë e të mesëm drejtues, nënpunës që kanë kompetenca

vendim-marrje, gjyqtarë, prokurorë, përmbarues, drejtues të shoqërive anonime me pjesëmarrje të kapitalit shtetëror mbi 50 %, zyrtarë të administratës tatimore, doganore, etj.

Gjithashtu këtu përfshihen dhe bashkëshortja dhe fëmijët madhore.

Çfarë duhet të bëni

Së pari, duhet të zgjidhni sa më shpejt konfliktet e interesit, nëse keni.

Së dyti, një kategori e caktuar zyrtarësh dhe familjarët e tyre, e kanë të ndaluar të ndërrmarrin aktivitete të përcaktuara në ligjin për konfliktin e interesave.

Së treti, çdo zyrtar eshte i detyruar tw bwjw një vetëdeklarim, rast pas rasti, kur përparrë një vendimmarrje publike ai është në konflikt me interesat e tij private.

Çdo institucion është i detyruar të mbledhë informacion në raste të Konfliktit të Interesave.

Disa kategori zyrtarësh duhet të bëjnë deklarim vjetor.

Ligji parashikon rastet e zgjidhjes së Konfliktit të Interesave.



Deklarimi rast pas rasti

Çdo zyrtar është i detyruar të bëjë një vetë-deklarim paraprak, rast pas rasti, nëse është në dijeni të ekzistencës së një interesit privat, i cili mund të ndikojë, apo të bëhet shkak për konflikt interesash

Ju duhet të bëni deklarim edhe kur kjo ju kërkohet nga eprori juaj.

Deklarata duhet të regjistrohet në regjistrat e çdo institucioni. Këto regjistra mund të bëhen publike.

Deklarimi Periodik

Personat që detyrohen të bëjnë një deklarim periodik janë zyrtarët e përcaktuar në nenin 3 të Ligjit 9049, datë 10.04.2003 dhe në nenin 4 të Ligjit 9367, datë 07.04.2005.

Formulari përfshin detaje mbi asetet, llogaritë rrjedhëse dhe çdo informacion tjetër i kërkuar në bazë të ligjit 9049, datë 10.04.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive...", si dhe dhurata, benefice dhe angazhime në organizata fitim prurëse dhe jo fitim prurëse.

Deklaratat e pasurisë janë të hapura për publikun.

Afati i dorëzimit të deklaratave është data 31 mars i çdo viti.

Deklarimi i parë (para fillimit të detyrës) duhet të bëhet brenda 30 ditëve.

Kush e administron ligjin për konfliktin e interesave

Çdo institucion duhet të emërojë një person përgjegjës. Zakonisht drejtorin e burimeve njerëzore.

Autoriteti qendror përgjegjës për zbatimin e këtij ligji është Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive.

Nëse nuk jeni të qartë për kërkesat e këtij ligji, duhet të kérkonи informacion.

Për informacione të tjera

Kopjet e ligjit për Konfliktin e Interesave mund t'i gjeni në Fletoren Zyrtare Nr. 31 Maj 2005, si dhe pranë çdo drejtorie të burimeve njerëzore në çdo institucion.

Ju mund të merrni informacion edhe nëpërmjet faqes së internetit
www.hidaa.gov.al
ose duke telefonuar pa pagesë në tel 0800 9999

I.L.D.K.P.

INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT
DHE KONTROLLIT TE PASURIVE



I.L.D.K.P.

INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE